



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 15917 Prot

Lezhë, më 26 / 09 /2022

VENDIM

Nr. 103, Datë 23 . 09 .2022

Për një shtesë dhe ndryshim në V.K.Bashkiak nr.177, datë 23.12.2021 “Për miratimin e Buxhetit për vitin 2022 dhe PBA-së 2022-2024

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”; dhe të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.16040, datë 29.08.2022 “Dërgohet fondi i rritjes së pagave për funksionin e arsimit parashkollor”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1.Miratimin e një shtese dhe ndyshimi në buxhetin e bashkisë për vitin 2022, si më poshtë:

1/1-Të shtohen burimet në buxhetin e bashkisë për vitin 2022 në shumën 2,227,263 lekë në programin buxhetor ‘09120’ – “Arsimi parashkollor dhe bazë”.

1/2-Të shtohen shpenzimet në programin buxhetor ‘09120’ – “Arsimi parashkollor dhe bazë” në shumën 2,227,263 lekë. Për këtë të kryhen veprimet si më poshtë:

- Pakësohet: - Gr.00, Prog.09120, Kap.01, Art.604 për shumën 2,227,263 lekë.
- Shtohet: - Gr.00, Prog.09120, Kap.01, Art.600 për shumën 1,908,537 lekë.
- Gr.00, Prog.09120, Kap.01, Art.601 për shumën 318,726 lekë.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT LEZHË

SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE E FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

CB
Nr. 15917/1 Prot.
28.9.2022

Nr. 647/3 Prot.

Lezhë, më 28.09.2022

L e n d a : Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për dijëni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 103, datë 23.09.2022 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “Për një shtesë dhe ndryshim në V. K. Bashkiak nr. 177, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2022 dhe PBA-së 2022-2024”.

PREFEKTI

Gjergj PRENDI

